



Figura 1 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave drejtpërdrejt




Në figurën 1, K Co është një kompani kosovare në të cilën A mban 60% të aksioneve, B mban 10% të aksioneve dhe C dhe D së bashku kanë 30% të aksioneve. Ndërsa A mban më shumë se 25% të aksioneve në K Co, A është pronar përfitues i K Co. B mban më pak se 25% të aksioneve në K Co, kështu që B nuk është pronar përfitues i K Co. C dhe D së bashku mbajnë më shumë se 25% të aksioneve në K Co, dhe si aksione të mbajtura bashkërisht duhet të trajtohen se u përkasin në tërësi, secilit person që i mban ato, C dhe D janë pronarët përfitues të K Co.

Figura 2 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave drejtpërdrejt




Në Figurën 2, F Fn është fondacion i huaj në të cilin A dhe C secili kanë 50% të të drejtave të votës, kështu që secili ka një zotërim prej më shumë se 25%. Që të dy kanë bërë marrëveshje me palët e treta rreth mënyrës në të cilën ushtrohen të drejtat e tyre të votimit. Sipas një marrëveshjeje që A ka bërë me B, A duhet t'i ushtrojë këto të drejta në mënyrën që B udhëzon. Kjo do të thotë se B, jo A, kontrollon të drejtat e mbajtura nga A, kështu që për qëllime regjistrimi B duhet të trajtohet si mbajtës i së drejtës, jo A, prandaj B është pronar përfitues i F Fn. Pozita është e ndryshme me C dhe D; C nuk është i detyruar të veprojë sipas udhëzimeve të D, por megjithatë është i detyruar të marrë pëlqimin e D para se të ushtrojë të drejtat që zotëron. Prandaj, C dhe D, të dy kontrollojnë ushtrimin e të drejtave të C kështu që për qëllime regjistrimi që të dy duhet të trajtohen si mbajtës të së drejtës dhe prandaj të dy janë pronarë përfitues të F Fn.

Figura 3 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave drejtpërdrejt




Në figurën 3, K Co është një kompani kosovare në të cilën A dhe B së bashku mbajnë 70% të të drejtave të votës, C mban 20% të të drejtave të votës dhe D mban 10% të të drejtave të votës. Përderisa A dhe B duhet të trajtohen si mbajtës të të gjitha të drejtave të tyre të përbashkëta për qëllime regjistrimi, secili ka më shumë se 25% të të drejtave të votës dhe si rrjedhim të dy janë pronarë përfitues të K Co. Edhe pse as C e as D nuk mbajnë më shumë se 25% të të drejtave të votës në K Co, ata kanë një marrëveshje afatgjatë në të cilën ata gjithmonë ushtrojnë të drejtat që mbajnë në të njëjtën mënyrë. Meqenëse të gjitha të drejtat që i nënshtrohen marrëveshjes duhet të trajtohen që u përkasin atyre për qëllime regjistrimi, secili trajtohet si mbajtës i 30% të të drejtave të votës. Prandaj C dhe D që të dy janë pronarë përfitues të K Co.

Figura 4 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – të emëruarit




Në figurën 4, F Co është një kompani e huaj në të cilën A mban 40% të aksioneve dhe B dhe C secili mbajnë 20% të aksioneve. Mbajtja e më shumë se 20% të aksioneve mund të ketë pasoja tatimore për C në juridiksionin në vendin e tij. Prandaj C emëron D, një ofrues i shërbimeve korporative, që të mbajë 20% të aksioneve si i emëruar i tij. Pasi që A mban më shumë se 25% të aksioneve në F Co, A është pronari përfitues i F Co. B mban më pak se 25% të aksioneve në F Co kështu që nuk është pronar përfitues i F Co. Edhe pse C mban vetëm 20% të aksioneve në emrin e tij, D mban edhe 20% të aksioneve si i emëruar i C-së. Meqenëse aksionet e mbajtura nga një individ në emër të një individi tjetër duhet të trajtohen për qëllime regjistrimi që i përkasin atij individi, aksionet e D-së duhet të trajtohen që i përkasin C-së, jo D-së. Kjo do të thotë se C mban më shumë se 25% të aksioneve në total kështu që C është një pronar përfitues i F Co.

Figura 5 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – të emëruarit




Në figurën 5, K Co është një kompani e themeluar nga A, një biznesmen ndërkombëtar, për të mbajtur pasurinë e tij. Pasi që A shpesh udhëton për biznes dhe e ka të vështirë të marrë pjesë në mbledhjet e aksionarëve ose për t'u marrë me administrimin e K Co, ai transferon të gjitha aksionet në K Co tek B, vëllai i tij, në mënyrë që ai të mund të merret me punët e përditshme në drejtimin e K Co në emër të tij. Pasi që B mban aksione në emër të A, aksionet e tij duhet të trajtohen se i përkasin A-së, e jo atij. Kjo do të thotë se A është pronar përfitues i F Co.

Figura 6 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – zinxhirët e pronësisë



Në figurën 6, K Co është kompani kosovare në të cilën 30% e aksioneve mbahen nga F Co (kompani e huaj) dhe A mban pjesën tjetër prej 70%. Prandaj, A ka zotërim të drejtpërdrejtë prej më shumë se 25% dhe është pronar përfitues i K Co. B mban 80% të aksioneve në F Co kështu që ka aksione indirekte në K Co që arrijnë në 24% në total (d.m.th. 80% nga 30%). Kjo do të thotë se B nuk ka zotërim të përgjithshëm në G Co prej më shumë se 25% sipas testit të kuantifikimit, por mban një pjesë të shumicës në një subjekt i cili zotëron më shumë se 25% të të drejtave të votës në G Co. Prandaj, B është një pronar përfitues i G Co. C dhe D secili mbajnë 10% të aksioneve në F Co kështu që secili ka aksione indirekte në G Co prej 3% në total (d.m.th. 10% nga 30%). Pasi që as nuk kanë zotërim të përgjithshëm në K Co prej më shumë se 25% sipas provës sasiore, e as shumicë të aksioneve në një subjekt që mban më shumë se 25% të të drejtave të votës në K Co, ata nuk janë pronarë përfitues të K Co.

Figura 7 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – zinxhirët e pronësisë




Në figurën 7, F LP është kompani e Kosovës me përgjegjësi të kufizuar në të cilën 52% e të drejtave të votës mbahen nga F Co (kompani e huaj) dhe F Fn, fondacioni i huaj, mban pjesën tjetër prej 48%.

A mban 50% të aksioneve në F Co kështu që ka mbajtje indirekte të të drejtave të votimit në F LP prej 26% në total (d.m.th. 50% nga 52%). Kjo do të thotë se A nuk zotëron shumicën e aksioneve në një subjekt që mban më shumë se 25% të të drejtave të votimit në F LP, por ka një zotërim të përgjithshëm në të drejtën e votimit në F LP sipas testit apo provës së sasisë prej më shumë se 25%. Prandaj A është pronar përfitues i F LP.

B dhe C secili mbajnë 25% të aksioneve në F Co kështu që të dy kanë zotërime indirekte të të drejtave të votimit në F LP prej 13% në total (d.m.th. 25% nga 52%). Pasi që as nuk kanë zotërim të përgjithshëm në të drejtat e votës në F LP sipas testit të kuantifikimit prej më shumë se 25% e as shumicë të aksioneve në një subjekt që mban më shumë se 25% të të drejtave të votës në F LP, ata nuk janë pronarë përfitues të F LP.

D ka interes përfitues prej 100% të aseteve në F Fn kështu që ka zotërim indirekt të të drejtave të votimit në F LP prej 48% në total (d.m.th. 100% nga 48%). Kjo do të thotë se D edhe zotëron shumicën e aksioneve në një subjekt që mban më shumë se 25% të të drejtave të votimit në F LP, por edhe ka një zotërim të përgjithshëm në të drejtën e votimit në F LP sipas testit apo provës së sasisë prej më shumë se 25%. Prandaj D është pronar përfitues i F LP sipas të dy testeve.

Figura 8 - Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – zinxhirët e pronësisë



Në figurën 8, K Co 1, K Co 2 dhe K Co 3 janë kompani kosovare. K Co 2 mban 30% të aksioneve në K Co 1, K Co 3 mban 20% të aksioneve në K Co 1 dhe K Co 4 mban 50% të aksioneve në K Co 1. A mban 80% të aksioneve në K Co 2 kështu që ka mbajtje indirekte të aksioneve në K Co 1 prej 24% në total (d.m.th. 80% nga 30%). Kjo do të thotë se A nuk ka një zotërim të përgjithshëm të aksioneve në K Co 1 sipas testit të

sasisë prej më shumë se 25%, por mban shumicën në një subjekt që zotëron më shumë se 25% të aksioneve në K Co 1. Prandaj A është pronar përfitues i K Co 1.


B mban 10% të aksioneve në K Co 2. Kjo do të thotë se B ka mbajtje indirekte të aksioneve në K Co 1 prej 3% në total (d.m.th. 10% nga 30%). Pasi që B as nuk ka zotërim të përgjithshëm në aksionet e K Co 1 sipas testit të kuantifikimit prej më shumë se 25% e as shumicë të aksioneve në një subjekt që mban më shumë se 25% të të drejtave të votës në K Co 1, B nuk është pronar përfitues i K Co1.

C mban 10% të aksioneve në K Co 2, 40% të aksioneve në K Co 3 dhe 40% të aksioneve në K Co 4. Megjithëse C nuk mban një shumicë të aksioneve në një subjekt që zotëron më shumë se 25% të aksioneve në K Co 1, C ka një zotërim të tërthortë në aksionet në K Co 1 sipas testit të sasisë prej 31%. Kjo përbëhet nga mbledhja e vlerës së pronave të C në çdo zinxhir të pronësisë, pra 3% (d.m.th. 10% e 30%), 8% (d.m.th. 40% e 20%) dhe 20% (d.m.th. 40%). Prandaj C është pronar përfitues i K Co 1.

D mban 60% të aksioneve në K Co 3 kështu që ka mbajtje indirekte të aksioneve në K Co 1 prej 12% në total (d.m.th. 60% nga 20%). Kjo do të thotë se A nuk ka një zotërim të përgjithshëm të aksioneve në K Co 1 sipas testit të sasisë prej më shumë se 25%, dhe nuk mban shumicën në një subjekt që zotëron më shumë se 25% të aksioneve në K Co 1. Prandaj D nuk është pronar përfitues i K Co 1.

E mban 60% të aksioneve në K Co 4 kështu që ka mbajtje indirekte të aksioneve në K Co 1 prej 30% në total (d.m.th. 60% nga 50%). Kjo do të thotë se A ka një zotërim të përgjithshëm të aksioneve në K Co 1 sipas testit të sasisë prej më shumë se 25%, dhe po ashtu mban shumicën në një subjekt që zotëron më shumë se 25% të aksioneve në K Co 1. Prandaj E është pronar përfitues i K Co 1 sipas të dy testeve.


Figura 9 - Mbajtja e të drejtës për të emëruar apo shkarkuar drejtorët apo zyrtarët tërthorazi



Në figurën 9, K Co është kompani kosovare në të cilën A, B dhe C secila mbajnë të drejtën për të emëruar shumicën e zyrtarëve. Prandaj të gjithë janë pronarë përfitues të K Co.

Në një rast më pak të drejtpërdrejtë, një subjekt mund të mbajë të drejtën për të emëruar ose shkarkuar drejtorët ose zyrtarët. Në atë situatë, një person fizik që ka shumicë të aksioneve në subjekt (qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet një zinxhiri të pronësisë) do të jetë në gjendje të kontrollojë ushtrimin e kësaj të drejte kështu që duhet të trajtohet si mbajtje e së drejtës në mënyrë indirekte. Prandaj, është e nevojshme të shqyrtohet mbajtja në çdo subjekt në një zinxhir të pronësisë në të njëjtën mënyrë siç është përshkruar më sipër. Kjo ilustron në shembujt në vijim.

Figura 10 - Mbajtja e të drejtës për të emëruar apo shkarkuar drejtorët apo zyrtarët tërthorazi




Në figurën 10, F Fn është një fondacion i huaj, kushtetuta e të cilit i jep A, B dhe një kompanie të huaj, F Co të drejtën për të emëruar shumicën e zyrtarëve të fondacionit. Kjo do të thotë se A dhe B mbajnë drejtpërsëdrejti të drejtën e emërimit dhe prandaj që të dy janë pronarë përfitues të F Fn.

C dhe D secili mban 20% të aksioneve në F Co. Pasi që kjo nuk është shumicë e aksioneve në subjekt që mban të drejtën e emërimit, as C as D nuk është pronar përfitues i F Fn.

Një LLP e huaj, F LLP, mban 60% të aksioneve në F Co. E mban 51% të të drejtave të votimit në F LLP. Kjo do të thotë se E mban shumicë të aksioneve (nëpërmjet një zinxhiri aksionesh të shumicës) në subjektin që mban të drejtën e emërimit. Prandaj E mban në mënyrë indirekte të drejtën e emërimit dhe është pronar përfitues në F Fn.

Figura 11 - Mbajtja e të drejtës për të emëruar apo shkarkuar drejtorët apo zyrtarët tërthorazi




Në figurën 11, K Co është kompani kosovare që ka lidhur një marrëveshje me shkrim duke i dhënë F LP, një partneritet i huaj me përgjegjësi të kufizuar dhe A të drejtën për të shkarkuar shumicën e bordit të drejtorëve të saj. A është e detyruar të ushtrojë këtë të drejtë në bazë të kontratës sipas udhëzimeve nga B. Kjo do të thotë se edhe pse A mban të drejtën e shkarkimit të drejtpërdrejtë, për qëllime regjistrimi, duhet të llogaritet se B mban këtë të drejtë në vend të A pasi që B kontrollon ushtrimin e saj në vend të A. Prandaj B është pronari përfitues i K Co.

C mban 48% të të drejtave të votës në F LP. Kjo do të thotë se C nuk mban shumicën në një subjekt që mban të drejtën e shkarkimit, kështu që nuk është pronar përfitues i K Co. D dhe E secili zotërojnë 26% të të drejtave të votës në F LP. Me një marrëveshje afatgjatë D dhe E gjithmonë ushtrojnë këto të drejta në të njëjtën mënyrë kështu që secili duhet të trajtohet se mban të gjitha të drejtat që janë pjesë e marrëveshjes. Kjo do të thotë se secili prej tyre mban 52% të të drejtave në F LP kështu që secili ka një shumicë të aksioneve në një subjekt që mban të drejtën e shkarkimit sa i përket K Co. Prandaj D dhe E janë pronarët përfitues të K Co.

Figura 12 - Kuptimi i kontrollit përmes mjeteve tjera


Në figurën 12, K Co është kompani kosovare e cila përfshin një biznes inxhinierie. Askush nuk gjendet brenda Nivelit 1 (kontrolli përmes pronësisë) dhe prandaj është e nevojshme të shqyrtohet nëse ndokush gjendet në Nivelin 2. A është themeluesi i biznesit dhe dokumentet zyrtare të K Co i japin atij të drejta të ndryshme mbi biznesin duke përfshirë të drejtën për të vënë veto për ndonjë plan biznesi. Prandaj A është pronar përfitues i K CO.

Figura 13 - Kuptimi i kontrollit përmes mjeteve tjera




Në figurën 13, F LLP është LLP e huaj në të cilën A mban 100% të të drejtave të votimit. Edhe pse A punon si kopshtar pa asnjë burim tjetër të ardhurash, F LLP ka asete të konsiderueshme. Punëdhënësi i A-së, B është afarist i njohur ndërkombëtar i cili është i famshëm për dëshirën e tij për privatësi, në veçanti lidhur me lokacionin e aseteve të tij. Kjo do të thotë se ka arsye për të besuar se, edhe pse A është një njeri pa integritet dhe për këtë arsye kontrollon F LLP përmes pronësisë, B gjithashtu përfundimisht kontrollon F LLP-në përmes mjeteve të tjera (p.sh. marrëdhënies së tij me A); që të dy A dhe B duhet të trajtohen si pronarë përfitues të F LLP-së.

Figure 14 - Kuptimi i kontrollit përmes mjeteve tjera




Në figurën 14, K Co është një kompani kosovare në të cilën A mban 90% të aksioneve dhe B mban 10% të mbetura të aksioneve. Kjo do të thotë se A kontrollon K Co përmes pronësisë kështu që A është pronar përfitues i K Co. A është biri i B. Megjithëse B mban më pak se 25% të të drejtave të votës kështu që nuk ka kontroll përmes pronësisë, B ka kontrollin përfundimtar përmes mjeteve të tjera pasi që A bën gjithnjë atë që dëshiron B në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me drejtimin e K Co. Prandaj po ashtu edhe B është pronar përfitues i K Co. C është kontabilist i K Co. Përveç përgatitjes së llogarive të K Co, C i jep këshilla nganjëherë K Co-së rreth planifikimit të tatimeve, por kjo nuk shkon përtej marrëdhënieve standarde midis klientit dhe kontabilistit. Prandaj C nuk është pronar përfitues i K Co.

Figure 15 - Kuptimi i kontrollit përmes mjeteve tjera



Në figurën 15 F Fn është fondacion i huaj në të cilin askush nuk gjendet brenda Nivelit 1 (kontrolli përmes pronësisë) dhe prandaj është e nevojshme të shqyrtohet nëse ndokush gjendet në Nivelin 2. Të gjithë zyrtarët e F Fn dhe ata që mbajnë të drejtën e votës në F Fn janë anëtarë të familjes së themeluesit të ndjerë dhe asnjëri prej tyre nuk ka ndonjë përvojë për qëllimet për të cilat është themeluar F Fn. Si rezultat, në praktikë ata gjithmonë kërkojnë dhe ndjekin këshillat e A, i cili është avokat i F Fn, për çdo çështje që lidhet me F Fn. Kjo përfshin pagesat për përfituesit, emërimet e stafit dhe gjëra të tjera që shkojnë përtej llojit të gjërave që zakonisht trajtohen nga një këshilltar ligjor. Efekti i kësaj është se A është në fund të fundit duke kontrolluar F Fn dhe kështu që është pronar përfitues i F Fn.

Figure 16 - Kuptimi i kontrollit përmes mjeteve tjera



Në figurën 16, K Co është kompani kosovare në të cilën A dhe B secila mbajnë 50% të aksioneve. Kjo do të thotë se A dhe B secili kontrollojnë K Co përmes pronësisë kështu që të dy janë pronarë përfitues të K Co. K Co shkon në likuidim dhe C emërohet si likuidator. Përdorimi nga C i aseteve të K Co-së dhe marrëdhëniet me zyrtarët e saj janë në përputhje me atë që normalisht do të pritej nga një likuidator. Prandaj C nuk është pronar përfitues i K Co.